



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 6 Prot.

Tiranë, më 13/05/2020

VENDIM

Nr. 4 datë 13.05.2020

PËR

**LLOGARITJEN E AFATEVE PROCEDURIALE NGA KOMISIONI
INSTITUCIONAL ZGJEDHOR (KIZ) NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË,
TIRANË**

Në zbatim të Rregullores së Zgjedhjeve miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr.13, datë 12.02.2020 “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” si dhe duke marrë parasysh aktet ligjore e nënligjore të nxjerra nga qeveria apo institucionet përkatëse të Republikës së Shqipërisë në lidhje me marrjen masave përkatëse për parandalimin e shpërhapjes së virusit Covid – 19, duke pezulluar edhe lëvizjen e njerëzve fundjavave apo ditë të caktuara, *Komisioni Institucional Zgjedhor,*

VENDOSI:

1. Afatet proceduriale të llogaritura me ditë kalendarike do të llogariten duke hequr ditët e fundjavës apo ditët e përcaktuara në të cilat nuk lejohet lëvizja e njerëzve për shkak të situatës së pandemisë, shkaktuar nga virusi Covid-19.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, afishohet në ambjentet e UMT-së dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

KRYETAR

SILVANA BALA